

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 349/ 2022, 15-12-2022****Parashikimi** nga 15-12-2022, ora 12:00 deri më 16-12-2022, ora 23:59.**PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PERMBYTJET**

Nga llogaritjet hidrologjike të IGJEO, gjatë ditës së sotme dt.15 Dhjetor dhe dy ditëve në vazhdim, lumenjtë Drin-Buna dhe Liqeni i Shkodrës do të vazhdojnë të kenë prurje dhe nivele të larta. Për pasojë pritet PËRKEQËSIMI I HARTËS SË PËRMBYTJEVE në pjesën e Nën Shkodrës dhe përmbytjes të zonave periferike të qytetit të Shkodrës në afërsi të Liqenit. Për arsye të shtimit të rrezikut nga përmbytja, është vendosur të mbahet shenja e paralajmërimit nga përmbytja për qarkun e Shkodrës.

Në pjesën tjetër të territorit përgjatë ditëve në vazhdim nuk parashikohet rrezik i shtuar nga përmbytjet në gjithë pjesët fushore të lumenjve.

Në qarqet Shkodër dhe Kukës pritet të ketë vërshime të shpejta të lumenjve si dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane të këtyre qarqeve pritet të ketë përmbytje të lokalizuara në varësi të gjendjes së kanalizimeve. Ky informacion do të përditësohet nga IGJEO sipas llogaritjeve më të fundit hidrologjike dhe do të njoftoheni për çdo ndryshim në parashikimin e përmbytjeve.

PARASHIKIMI METEO**RESHJET**

Sot pasdite (e enjte, dt.15) dhe nesër (e premte, dt.16) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarqet Shkodër dhe Kukës. Reshjet pritet të shoqërohen dhe me shtrëngata në këto qarqe. Gjithashtu priten reshje mesatare në qarqet Dibër, Lezhë, Durrës si dhe reshje të dobëta në qarqet e tjera (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

TEMPERATURAT

Nesër (e premte, dt.16) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë: në bregdet: 15 / 22 °C, në vendet e ulëta: 14 / 22 °C, në vendet malore: 7 / 17 °C

ERA

Sot pasdite (e enjte, dt.15) dhe nesër (e premte, dt.16) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

NIVELET E RREZIKUT**S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: Entela Vako

Koordinator: Alban Doko (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 1 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)






Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 349/ 2022, 15-12-2022


Parashikimi nga 15-12-2022, ora 12:00 deri më 16-12-2022, ora 23:59.

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare					
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare					
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare					
TIRANË	S'KA RREZIK	të dobëta					
ELBASAN	S'KA RREZIK	të dobëta					
FIER	S'KA RREZIK	të dobëta					
BERAT	S'KA RREZIK	të dobëta					
KORÇË	S'KA RREZIK	të dobëta					
VLORE	S'KA RREZIK	të dobëta					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	të dobëta					

LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 15 – 16.****LEGJENDA: Zjarre në pyje**

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

SIMBOLE

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke